



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 5 dt. 10.03.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 10.03.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Lengarica & Energy” shpk për ndërtimin e veprës inxhinierike “Hidrocentrali në rrjedhën e lumit Langarica, diskutuar në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, referuar procedurave administrative, që aplikon Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë për miratimin e kërkesave sipas nenit 47 të ligjit “Për Trashëgiminë Kulturore”,

VENDOSI:

1. Shoqëria “Lengarica & Energy” shpk, duhet t’i drejtohet KKA, për të bërë të mundur lidhjen e kontratës dy palëshe, midis subjektit tuaj dhe Agjensisë së Shërbimit Arkeologjik.
2. Pas realizimit të kësaj procedure, kërkesa e shoqërisë “Lengarica & Energy” shpk, do të shqyrtohet nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike, për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI